



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 34

Prishtinë, më 10.07.2018, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Bilall Sherifi, Nezir Çoçaj, Shkumbin Demaliaj, Frashër Krasniqi dhe Igor Simiq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Labinot Leposhtica, BIRN; Paris Guri, KDI; Fitore Sopjani, praktikante; Gzim Shala, IKD/BPD; Albana Hajdari, Kosova Post; Valbona Bytyçi, Ekonomia Online; Dibran Istrefi, Klan KOSOVA; Edita Kusari, EUSR/EUO; Floriana Rugova, MD; Genc Nimoni dhe Arton Demahasaj, Çohu; Altina Besimi, British Embassy; Berita Abazi, GP/LV; Rreze Hoxha, GLPS; Ardiana Hajzeri, Radio Kosova dhe Sanije Berisha, OSBE.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit.

Nga stafi mbështetës: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-085 për mbrojtjen e Sinjalizuesve;
4. Procedimi i Projektligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim;

5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial “ Adem Jashari” në Prekaz;
6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 06/L-049 për Inovacion shkencor dhe transfer të dijes dhe teknologjisë;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshime duke u shtuar në pikën të ndryshme A. Vizitë Këshillit Grevist të Administratës së Gjykatës dhe Prokurorisë dhe B. Diskutim në lidhje me Projektligjet për Sistemin e Drejtësisë për kriterin se mund të jesh gjyqtar apo prokuror nëse është i dënuar për vepër penale.

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë

Kryetarja paraqiti në shqyrtim në parim projektligjin nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë i cili i ka 26 nene dhe barra e provës vendoset te prokurori. Deri tani kjo ka qenë koncept i dështuar sepse për vite radhazi ka pasur rregullime të tilla. Ndaj duke pasur parasysh rrethanat politike në Kosovë edhe si subjekt politik konsiderojmë se barra e provës duhet të vendoset tek i dyshuari dhe jo te prokurori duke pohuar se ndoshta mund të ketë kombinim, por në asnjë rrethanë të mbetet te prokurori. Gjithashtu znj. Haxhiu tha se prandaj edhe propozuan projektligjin për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme ku edhe dallojnë në adresime dhe qëndrime këto dy projektligje dhe pa kaluar ky projektligj në Kuvend ne, si Grup Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje nuk japim mbështetje për projektligj tjetër sepse e kemi provuar që projektligji i mëhershëm ka qenë i dështuar dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Hajdar Beqa tha se këto projektligje janë shumë të rëndësishme të cilat duhet të votohen në parim në Komision sepse janë edhe kriter për liberalizim të vizave për të cilat jemi afër këtyre objektivave. Për këtë projektligj ka dhënë kontribut shumë ekspertë, shoqëria civile, por edhe disa ambasada kanë dhënë përkrahje. Barra e provës bazën e ka në Kodin Penal dhe ne, si Grup Parlamentar i PDK-së, e mbështesim projektligjin e propozuar nga Qeveria dhe konsideroj që ky projektligj duhet të miratohet në parim nga komisioni dhe pas miratimit në parim shqyrtimi i dytë i këtij projektligji duhet të bëhet me procedurë të përsheptuar me shmangie nga afatet procedurale të paraparë me nenin 57, paragrafët 3, 8 dhe 9, dhe neni 64, paragrafi 4 i Rregullores së Kuvendit sipas procedurave në vijim: Amendamentet mund t'i adresohen Komisionit Funkcional në 17 korrik 2018. Komisioni Funkcional dhe Komisionet e Përhershme duhet të shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit të ia paraqesin raportin me rekomandime për shqyrtim të dytë për seancë plenare deri me 25 korrik 2018, kure për shqyrtim do të vendosë seanca. Më tej z. Beqa shtoi se ky projektligj është shumë i rëndësishëm ku përmes këtij do të luftohet korrupsioni dhe krimi i organizuar, ndaj kërkoi që ky projektligj të marri përkrahjen në parim.

Sami Kurteshi tha se e kam konsultuar çdo dokument në të cilën thirret Qeveria për konsultimin e ligjit në dokumentet Evropiane dhe pikërisht këtë projektligj që ka propozuar Qeveria prek

thelbin që ka sjellë gjendjen në Kosovë në lidhje me korrupsionin sepse i shmanget një gjëje shumë të rëndësishme në emër të ndryshimit të paradigmës ligjore, s'mundet dikujt t'i merret pasuria askujt para se të shpallet fajtor. Kjo duket që është mashtrim optik. Ka edhe një koncept në Unionin Evropian, e cila është ngrirja e pasurisë e cila nuk ka nevojë për asnjë vendim gjyqësor, ndërkohë që propozimi i Qeverisë nuk e parashihet ngrirjen e pasurisë. Më tej z. Kurteshi propozoi që t'i shohim këto dy projektligje për konfiskimin i pasurisë së pajustificueshme, që nga ngrirja, dyshimi, pandehja, akuzimi dhe deri te konfiskimi i saj duke i ftuar të gjithë ata që e njohin këtë fushë.

Hajdar Beqa tha se mes dy leximeve mund të japim kontributin tonë për këtë projektligj, ndërsa sa i përket projektligjit që e ka propozuar Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes, ne kemi dhënë mendim dhe në seancë plenare ka shkuar pa përkrahjen e komisionit. Ndër tjera z. Beqa kërkoi që të votohet në këtë fazë ky projektligj dhe njëkohësisht pajtohet me z. Kurteshi që jo të gjitha projektligjet që propozohen nga Qeveria janë të mira, por në fazën amendamentit në komision mund të rregullohen këto projektligje.

Korab Sejdiu tha se kemi shumë problem me propozimet që po na vijnë nga Ministria e Drejtësisë ku fokusi është i përqendruar më shumë në kuantitet sesa në kualitet, ndaj më mirë është të mos thirremi në ekspertë. Po flasim për dy projektligje që trajtojnë çështje të ndryshme ku projektligji i propozuar nga Qeveria adreson çështje të ndryshme ku konfiskimi i pasurisë bëhet kur dikush shpallet i fajshme në procedurë penale, ndërsa propozimi i Grupit Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka të bëjë me konfirmimin e pasurisë e cila nuk mund të arsyetohet nga një person. Çështja tjetër ka të bëjë me liberalizimin e vizave ku në njërin anë thuhet se janë përmbushur kushtet, ndërsa në anën tjetër thuhet se duhet t'i miratojmë edhe këto ligje që janë për liberalizim të vizave, për çka mendoj se Kosova i ka përpushur të gjitha kushtet që i janë dhënë Kosovës nga BE në letër dhe tani topi i mbetet Bashkimit Evropian të vendos për liberalizimin e vizave sepse nuk mund të ketë kushte tjera. Në fakt ne po mundohemi që të përmbushin kushte që nuk janë kushte dhe në këtë mënyrë ne nuk mund të sakrifikojmë kualitetin e legjislacionit tonë sepse biem jo serioz. Ndërkaq sa i përket shpejtësisë jam shumë dakord të punohet më shpejt sa kemi kapacitet personal dhe profesional, por kur flasim për Projekt- Kodin Penal dhe për projektligjin për konfiskimin e pasurisë janë çështje që prekin në thelb të drejta të garantuara jo vetëm me Kushtetutën tonë, por edhe me Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut. Me tej tha se ky projektligj lë shumë për të dëshiruar ashtu, si edhe propozimet e tjera nga Ministria e Drejtësisë, por mund të trajtohet apo të përmirësohet mes dy leximeve dhe secili deputet vendos nëse i jep përkrahje apo jo për ta proceduar për seancë, dhe seanca vendos.

Bilall Sherifi tha se mos t'ia hedhim fajin ekspertëve, por të japim kontributin personal tonën dhe mos të bëjmë politikë duke mbrojtur pozitën apo opozitën. Po ashtu z. Sherifi ju referua edhe ligjit të Antimafias në Shqipëri duke thënë se ne mund të marrim ligin që ka Shqipëria meqenëse ato e kanë bërë para nesh i cili është shumë i vështirë për tu zbatuar që sipas delegacionit homolog nga Shqipëria mund të kthehet në 'Gjueti Shtrigash'. Si përfaqësues i 'Nismës' do ta votoja ligjin që ka Shqipëria pa asnjë dallim. Në këtë fazë e përkrah këtë projektligj duke e votuar në parim.

Sami Kurteshi sqaroi se nuk pajtohet me parimin themelor që e ka Qeveria sepse nuk përputhet me dokumente të Unionit Evropian, sepse nuk përputhet me të vërtetën e zhvillimeve në Kosovë, sepse nuk është ligj në atë për të cilën synon.

Shkumbin Demaliaj tha se projektligji i propozuar nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje është i periudhës akuzatore dhe nuk mund të bëhet Kosova shtet policor duke akuzuar njëri-tjetrin për diçka. Pra, në këtë fazë ta përkrahim këtë projektligj në parim dhe ta procedojmë për seancë plenare.

Frashër Krasniqi tha se në këtë projektligj bëhet fjalë për konfiskimin e pasurisë të dënuar për veprë penale, por mos të harrohet që pjesa më e madhe e pasurisë që është përvetësuar në mënyrë të pajustificueshme e shumë shpesh kriminale në Kosovë është mbuluar në mënyrë të tillë, që nuk mund të konfiskohet duke ngritur vepra penale. Ndër të tjera z. Krasniqi tha se edhe Projektligji për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme, por edhe Projektligji nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë janë të nevojshme sepse mbulojnë çështje të ndryshme.

Kryetarja tha se si Grup Parlamentar jemi marrë shumë me çështjen e konfiskimit duke bërë shumë analiza, raporte dhe hulumtime dhe sa i përket konceptit të konfiskimit kanë të drejtë. Që nga viti 2004 kemi pasur politikan, zyrtarë të lartë, jaka të bardha që sistemi i drejtësisë ka dështuar që ta verifikojë se si janë pasuruar ata persona. Pasuritë që deklarohen janë në shpërputhje me të ardhurat që i kanë. Prokuroria ka dështuar që ta konfiskojë pasurinë e pajustificueshme sepse zyrtarët e lartë nuk po dënohen. Po të dënohen zyrtarët e lartë për veprë penale ky projektligj do të ishte i pranueshëm sepse prokuroria po guxon të dënojë zyrtarët e lartë. Nëse Kosova do të kishte këtë projektligj më parë natyrisht që sot nuk do të kushtëzoheshim ndaj kriterit të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe që moti do e kishim liberalizimin e vizave, zhvillimin ekonomik, mirëqenien sociale etj. Direktivat e Bashkimit Evropian ia kanë lënë vetë autorizimin shteteve anëtare që të vendosin vetë sesi dëshirojnë ta kenë konceptin e konfiskimit, tek i dyshuari apo te prokurori dhe në Kosovë ka dështuar që barrën e provës me e vendos te prokurori sepse sot një prokuror nuk e përfytyron dot sesi është të dënojë apo t'i konfiskojë pasurinë një zyrtari të korruptuar. Prandaj projektligji i propozuar nga Lëvizja Vetëvendosje është i jashtëzakonshëm për rrethanat që jemi ndonëse ka nevojë që të ketë edhe dispozita garantuese në mënyrë që askujt nuk do t'i bëhet e padrejtë ku do të konfiskohet vetëm pasuria e cila nuk mund të justifikohet. Në bazë të një hulumtimi Shqipëria e ka kështu Masa e konfiskimit të pasurisë vendoset me kërkesën e prokurorit i cili paraqet gjykatës arsyet ku bazohet kërkesa. Konfiskimi i pasurisë kërkohet të vendoset edhe në rastet kur ndaj pasurive nuk është kërkuar dhe vendosur masa e sekuestrimit. Barra e provës për të vërtetuar se pasuria është vendosur në mënyrë të ligjshme i përket personit kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi. Sa i përket kriterit të liberalizimit të vizave ka pas një sërë çështjes që është dashur të votohen në shpejtësi dhe sigurisht që kemi nevojë të ndërmarrim veprime radikale për me i dërguar në burg ata të cilët e kanë vjedhur pasurinë publike dhe për t'ia konfiskuar pasurinë atyre që e kanë fituar në mënyrë të pajustificueshme apo të paligjshme.

Bilall Sherifi tha se nuk po e konteston atë pjesë se çfarë thatë ju, por kur fillon sipas ligjit dhe nga momenti që shkaktohet një veprë penale fillon hetimi pasuror dhe për të vërtetuar pasurinë. Nga ai moment që i akuzuari është kapur me korrupsion apo me krim të organizuar fillohet një veprë e re penale. Pra, barra e provës është te i akuzuari kur t'i hapet vepra penale pasi t'i hapet një tjetër veprë penale duke pohuar edhe një herë se ligjin e Shqipërisë është i gatshëm ta

mbështesë kur do që të procedohet dhe nuk ka kundërthënie në këtë mes. Më tej z. Sherifi tha se propozimi i Grupit Parlamentar Vetëvendosje rrezikon liritë dhe të Drejtat e qytetarëve.

Korab Sejdiu propozoi që të kërkohet nga KDI, si komision të bëhet një hulumtim se si e adresojnë çështjen e konfiskimit të pasurisë edhe si rezultat i veprës penale, por edhe pa u dëshmuar fajësia paraprakisht në mënyrë që të eliminohen dyshimet që janë shfaqur në lidhje me këto dy projektligje të propozuara.

Pas diskutimeve kryetarja konstatoi se komisioni me **7 për, 2 kundër** dhe **1 abstenim** vendosi që Kuvendit të ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet, në parim, Projektligji nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë.

Ndërsa rekomandimi për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit të cilin e propozoi z. Hajdar Beqa si më poshtë vijon:

‘Pas miratimit në parim shqyrtimi i dytë i këtij projektligji duhet të bëhet me procedurë të përshpejtuar me shmangie nga afatet procedurale të paraparë me nenin 57, paragrafët 3, 8 dhe 9, dhe neni 64 paragrafi 4 i Rregullores së Kuvendit sipas procedurave në vijim: Amendamentet në Projektligj mund ti adresohen Komisionit FunkSIONAL në 17 korrik 2018. Komisioni FunkSIONAL dhe Komisionet e Përhershme duhet të shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit të ia paraqesin raportin me rekomandime për shqyrtim të dytë për seancë plenare deri më 25 korrik 2018, kurse për shqyrtim të dytë të Projektligjit nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë bëhet në një seancë të veçantë plenare.’

Nuk mori përkrahjen e Komisionit pasi u votua me **6 vota ‘për’ dhe 4 ‘kundër’**, sepse sipas Rregullores së Kuvendit neni 84 kërkohen 2/3 e të pranishmëve.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-085 për mbrojtjen e Sinjalizuesve

Kryetarja paraqiti në shqyrtim në parim Projektligjin nr. 06/L për mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe tha se do ta mbështesim këtë projektligj si Grup Parlamentar sepse është një projektligj jashtëzakonisht i duhur dhe shumë i rëndësishëm. Ndërkohë që deri tani ka qenë ligji për mbrojtjen e informatorëve, por që ka qenë një ligj i pa zbatuar dhe ka pasur shumë kundërthënie ndërmjet vetes. Më tej tha se në bazë të informacioneve që posedon, janë marrë parasysh edhe vërejtjet e shoqërisë civile dhe ne, si Grup Parlamentar, do të japim kontributin tonë në lidhje me këtë projektligj. Po ashtu tha se në Projekt-Kodin Penal kam propozuar amendament që lidhet me këtë projektligj sepse në kaluarën ka pasur raste të shumta kur zyrtarët kanë raportuar shkeljet e kundërligjshme gjë që ka pasuar me largim nga vendet e tyre të punës si shenjë hakmarrje. Pra, në parim e përkrahim këtë projektligj dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Hajdar Beqa tha se edhe ne, si Grup Parlamentar, do ta përkrahim dhe do të japim kontributin tonë për këtë projektligj.

Korab Sejdiu tha se një prej problemeve kyçe në shoqërinë tonë është që dëshira dhe vullneti i qytetarëve tonë të cilët janë dëshmitarë të veprimeve të kundërligjshme, janë për t'i deklaruar këto veprime në organet kompetente. Por, edhe ata duhet të kenë mbrojtjen e nevojshme ndaj hakmarrjes për veprimet e tyre, kështu që ky projektligj është i mirë dhe shkon në drejtimin e duhur për trajtimin e kësaj çështje. Pa ashtu do duhet të kemi shumë kujdes në mënyrë, që mos të ndërhyjmë në projektligj për të ia humbur kuptimin dhe të dëmtojmë frymën e këtij ligji.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni, njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

Të miratohet, në parim, Projektligji nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

4. Procedimi i Projektligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim

Kryetarja paraqiti procedimin e Projektligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim dhe tha se ka kohë që është në komision që i ka kaluar të gjitha afatet dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja, konstatoi se komisioni njëzëri e procedoi për Kuvend Projektligjin nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim.

5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial “ Adem Jashari” në Prekaz

Kryetarja paraqiti para komisionit raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni, njëzëri, vendosi që Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” , është në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Projektligjin nr. 06/L-049 për Inovacion shkencor dhe transfer të dijes dhe teknologjisë.

Kryetarja paraqiti para komisionit raportin me amendamente të Komisionit Funkcional për Projektligjin nr. 06/L-049 për Inovacion shkencor dhe transfer të dijes dhe teknologjisë dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni, njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 06/L-049 për Inovacion shkencor dhe transfer të dijes dhe teknologjisë është në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm;
2. Projektligji mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

7. Të ndryshme

A. Vizitë në Pallatin e Drejtësisë

Kryetarja kërkoi që të bëhet një vizitë administratës së Gjykatës dhe Prokurorisë për t'i dëgjuar më nga afër shqetësimet e tyre me rastin e hyrjes në grevë.

Anëtarët e Komisionit vendosën që në orën 13:00 dt. 10.07.2018 të vizitohet administrata e Gjykatës dhe Prokurorisë për të dëgjuar shqetësimet e tyre.

B. Diskutim në lidhje me kriterin për të qenë prokuror apo gjyqtar nëse do të jetë i dënuar me vepër penale.

Kryetarja tha se është një çështje që duhet të diskutohet në lidhje me kriterin për të qenë gjyqtar apo prokuror sepse kemi hasur në diskutime lidhur me këtë. Znj. Haxhiu pyet se a duhet të jetë kriteri i dënuar vetëm me vepër penale, që është kriteri goxha i lartë apo është i dënuar me vepër penale me përjashtim të veprave penale të kryera nga pakujdesia dhe kërkoi kontributin e anëtarëve në lidhje me këtë çështje.

Sami Kurteshi tha se kemi diskutuar gjatë për këtë çështje në grupe të punës dhe në Kodin Penal ka përcaktime dhe nuk mundemi gjithmonë drejtpërdrejt të nxjerrim diçka të re, por të shohim dhe të normat që përcaktojnë veprat penale për të cilat nuk ka nevojë të largojmë një gjyqtar apo prokuror nga detyra. Pra, nga Kodi Penal mund t'i përmbledhim të gjitha ato vepra penale në sintangmën nga 'pakujdesia'.

Hajdar Beqa tha se ne duhet të bëjmë një sistem të drejtësisë të fortë, fuqishëm dhe të besueshëm duke pohuar se përcaktimi i veprës penale të kryer mbetet në diskrecion të gjykatës, por brenda

normave të Kodit Penal. Më tej tha se e mbështes idenë që duhet të jetë, vepra penale e kryer nga ‘pakujdesia’

Shkumbin Demaliaj tha se është mirë të jetë pastërtia individuale e figurës së këtyre njerëzve që mund të jenë gjyqtarë dhe prokurorë të ardhmen, por do ishte mirë që në përshkrim të futen edhe librat e evidencave të veprave penale se nëse është në evidenca nuk mund të bëhet gjyqtar dhe prokuror.

Korab Sejdiu tha se vështirë është të japësh një mendim në lidhje me këtë çështje sepse edhe vepra penale nga pakujdesia janë mjaft serioze që nuk mendoj që duhet të jenë të përjashtuar nga ky rregull. Do ishte mirë që ne të vijë me propozime konkrete dhe mos të vendosim sot për të shkuar me një alternativë tjetër përveç kësaj që është në projektligj ‘mos të jetë i dënuar për vepër penale’. Në Kodin Penal janë të përcaktuara saktë ‘dënimi për vepër penale’ dhe ‘vepër penale nga pakujdesia’.

Arben Gashi tha se në më shumë po ndikohemi prej rrethanave dhe vendeve tjera në rajon si e kanë trajtuar këtë punë sesa si nevojë e brendshme. Jam i bindur se problemin kryesor që e ka sistemi prokurorial dhe gjyqësor është kompetenca profesionale sa janë profesionalisht kompetent për të kryer punën e vet. Problemi nuk është para se të hyjnë në sistem se çfarë kanë bërë ashtu siç i kanë vendet e rajonit ndoshta, por pasi të hyjnë në sistem është problem te ne se sa marrin ato vendime, sa e shkruajnë mirë vendimin, sa janë të përgatitur profesionalisht, sa vendime hidhen poshtë, sa vendime rigjykojnë etj. Ndaj, duhet të jemi të kujdesshëm duke mos të japim instrumente të rrezikshme për institucionin dhe shoqërinë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Albulena Haxhiu